



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 02, Datë 06.01.2025

MBI

LICENCIMIN E SHOQËRISË “DESLA” SH.P.K. NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT
TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16, 37, pika 2, gërma “a”, 38 pika 1, gërma “a” 39, pika 4, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, gërma “a”, 5, pika 1, gërma “a”, 13 dhe 14, pika 9, të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 06.12.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2426/6 prot., datë 27.12.2024, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë “DESLA” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “DESLA” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE nr. 2426 prot., datë 20.11.2024, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik me kapacitet prodhues 3 MW, me vendndodhje në Zonën Kadastrale nr. 8517, Bashkia Durrës, Qarku Durrës.
- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 260, datë 02.12.2024, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “DESLA” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.
- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e procedurës (në datat 03.12.2024 dhe 04.12.2024) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 12.12.2024), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.
- Gjithashtu, me shkresën nr. 2426/4 prot, datë 05.12.2024, ERE ka njoftuar Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) për fillimin e kësaj procedure, duke i kërkuar gjithashtu që të shprehet nëse ka një qëndrim ndryshe në lidhje me vlefshmërinë e kontratës së paraqitur

në kuadër të këtij aplikimi dhe të drejtën e shoqërisë “DESLA” sh.p.k. për ndërtimin dhe shfrytëzimin e këtij burimi gjenerues. Deri në këtë vendimmarrje, nga MIE nuk ka patur asnjë përgjigje.

- Me shkresën nr. 2426/3 prot., datë 05.12.2024, ERE ka njoftuar shoqërinë për këtë vendim dhe i ka kërkuar plotësimin e informacionit/dokumentacionit të konstatuar të munguar. Në vijim, shoqëria ka depozituar dokumentacionin plotësues me shkresën e protokolluar në ERE nr. 2426/5 prot., datë 10.12.2024.
- Nga analizimi i aplikimit, në referencë të përcaktimeve të “*Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike*”, të ndryshuar, rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të Aneksit A dhe ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar në zbatim të nenit 9, për pikën 1.1, gërmat “a” “b” dhe “c”; për pikën 1.2, gërmat “a” “b”, “c” dhe “d”; për pikën 1.3, gërmat “a”, “b” dhe “c”; dhe për pikën 2.1 gërmat “b”, “c”, “d”, “e” dhe “f”.
- Rezulton se shoqëria “DESLA” sh.p.k.:
 - Ka nënshkruar me MIE, kontratën nr. 3139 rep., nr. 2348 kol., datë 16.09.2024 “*Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike, me kapacitet prodhues 3 MW, dhe veprave ndihmëse, i cili nuk është objekt koncesioni, në Zonën Kadastrale nr.8517, Bashkia Durrës, Qarku Durrës*”, nënshkruar ndërmjet MIE-s dhe Mbajtësit të Miratimit për Ndërtim, shoqërisë “DESLA” sh.p.k.
 - Ka marrë miratimin e pikës së lidhjes së centralit me rrjetin e shpërndarjes nëpërmjet shkresës së shoqërisë “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” (OSSH) sh.a., nr. 2981/3 prot., datë 30.03.2023.
 - Është pajisur me Vendim për VNM Paraprake, lëshuar më datë 11.07.2023 nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), për të zhvilluar projektin “*Ndërtimi i centralit fotovoltaike Desla Solar, 3 MW*”, për shoqërinë “DESLA” sh.p.k.
- Në nenin 4 të kontratës së nënshkruar me MIE-n, nr. 3139 rep., nr. 2348 kol., datë 16.09.2024, specifikohet se kontrata lidhet për një afat 49-vjeçar, nga data e hyrjes në fuqi të saj, me të drejtë ripërsëritjeje. ERE, në zbatim të nenit 38, pika 1, gërma “a” të ligjit nr. 43/2015 “*Për sektorin e energjisë elektrike*”, i ndryshuar, dhe nenit 5, pika 1, gërma “a” të “*Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike*” e ndryshuar, lëshon një licencë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike deri në 30 vjet. Shoqëria ka depozituar garancinë 30-vjeçare për panelet fotovoltaike, ndaj dhe afati i licencës vlerësohet që të jetë për 30 vjet.

- Në referencë të përcaktimeve të nenit 9 të Kontratës nr. 3139 rep., nr. 2348 kol., datë 16.09.2024, të nënshkruar me MIE-n, shoqëria duhet të pajiset me lejet përkatëse, të ndërtojë dhe vendosë në operim centralin brenda datës 09.04.2027, ndaj vlerësohet t'i lihet kusht shoqërisë që të fillojë operimin e centralit dhe ushtrimin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike brenda këtij afati.
- Rezulton se shoqëria disponon një VNM të vlefshme (deri më 11.07.2025), ndaj vlerësohet që në kuadër të mbikëqyrjes shoqëria të raportojë çdo tre muaj në ERE, lidhur me fillimin e punimeve brenda këtij afati.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të licencojë shoqërinë “DESLA” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik me kapacitet prodhues 3 MW, me vendndodhje në Zonën Kadastrale nr. 8517, Bashkia Durrës, Qarku Durrës, për një afat 30-vjeçar.
2. Shoqëria duhet të fillojë ushtrimin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike brenda datës 09.04.2027.
3. Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE.
4. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve, të njoftojë shoqërinë “DESLA” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, “OSSH” sh.a., “FTL” sh.a. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI